

VENDIM
Nr. 4, datë 3.2.2025

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 234, datë 25.10.2024, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 4, datë 3.2.2025 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, Fondi i Veçantë. Dosje personale nr. 2670 dhe dosje pune nr. 42 në ngarkim të E. H., me 2 volume në total me 559 (pesëqind e pesëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1972–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4 të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula